



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

## AUTORITETI I KONKURRENCËS

### VENDIM

**Nr. 878, Datë 15.04.2022**

**“Për**

**rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK për revokimin e  
Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.04.2022 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK për revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.

**Bazë ligjore:** Neni 24, shkronja d), neni 26, neni 46 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (Ligji nr. 9121/2003);

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK për revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës, si dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

### VËREN SE:

1. Ndërmarrja AGRO BLEND SHPK me anë të shkresës së saj nr. 310 prot., datë 05.04.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 256 prot, dt. 06.04.2022), me lëndë “Ankim kundër Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 874, datë 25.03.2022”, kërkon nga Komisioni i Konkurrencës revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022, pasi kjo ndërmarrje bazuar në KPrA, si dhe nenin 46, pika c), të ligjit nr. 9121/2003, gjykon se ky vendim është marrë mbi të dhëna jo të plota dhe aspak të sakta, duke paraqitur dhe argumentet mbi të cilat e mbështet kërkesën e saj.
2. Komisioni i Konkurrencës mori në shqyrtim kërkesën e ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK dhe argumentet e paraqitura prej saj, argumente këto të cilat janë parashtruar me shkrim nga ana e kësaj ndërmarrjeje pas seancës dëgjimore të zhvilluar me Komisionin e Konkurrencës më datë 17.03.2022, para marrjes së vendimit

përfundimtar nr. 874, datë 25.03.2022 objekt ankimimi, duke mos paraqitur fakte dhe të dhëna shtesë lidhur me këtë vendimmarrje.

3. Bazuar në nenin 32 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti, në ushtrimin e funksionit të tij, zbaton Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.
4. Në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, procedura administrative e hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure ka përfunduar me marrjen e vendimit administrativ përfundimtar nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës, vendim i cili, në respektim të nenit 79 të ligjit nr. 9121/2003, mund të ankimohej në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin.
5. Procedura e revokimit të një vendimi të Komisionit të Konkurrencës parashikohet në ligjin e posaçëm, konkretisht në nenin 46 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit revokimi i këtij Vendimi mund të kryhet nga Komisioni i Konkurrencës vetëm kur përmbush të paktën njërin nga 3 kriteret e përcaktuara në këtë nen.
6. Në respektim të këtij neni Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:
  - a) Njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit kanë ndryshuar;
  - b) Palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
  - c) Vendimi është bazuar në të dhëna jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.
7. Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK dhe i argumenteve të dhëna nga kjo ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi përpara kushteve të përcaktuara në ligjin e posaçëm. Pra, në kuptim të nenit 46 të ligjit nr. 9121, datë 28.09.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), dhe nenin 46 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

- I. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK për revokimin e Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.

- II. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 874, datë 25.03.2022 të Komisionit të Konkurrencës.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**